



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 17 dhe nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për njësitë: HC "Brod I" 1062 kW, HC "Brod III" (Kukalane) 3120 kW dhe HC "Restelica III" (Globoqicë) 1498 kW, në Komunën e Dragashit, të datë 06.08.2014, nr. 3070/14 të shoqërisë "Eurokos JH" sh.p.k., me adresë rruga 20 "Zenun Beqa", Ferizaj, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 03 tetor 2014 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet** Kërkesa për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012 i datës 10 shkurt 2012, dhe **përfundon** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012 i datës 10 shkurt 2012, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga uji, për njësitë: HC "Brod I" 1062 kW, HC "Brod III" (Kukalane) 3120 kW dhe HC "Restelica III" (Globoqicë) 1498 kW, në Komunën e Dragashit.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 29.09.2011 nga shoqëria "Eurokos J.H." SH.P.K. ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.33 MW që përbëhet prej gjashtë (6) njësie gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC "Brod I" (Brod) 1062 kW; HC "Brod II" (Dikance) 1250 kW; HC "Brod III"(Kukalane) 3120 kW; (totali 5432 kW) dhe HC "Restelica I" 1200 kW; HC "Restelica II" (Krushevë) 1200 kW dhe HC "Restelica III" (Globoqicë) 1498 kW (Totali 3898 kW), të gjitha në komunën e Dragashit.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, me datë 10 shkurt 2012 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.



- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se ndërmarrjes “Eurokos JH” sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- ZRRE me datë 07.08.2013 fillimisht ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji në Autorizim për dy (2) njësit gjeneruese HC “Brodi II” me kapacitet prej 1.25 MW dhe HC “Restelica II” me kapacitet prej 1.2 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë relevante.
- ZRRE me datë 21.10.2013 ka pranuar kërkesën me ndryshime për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC “Brod II” me ndryshim të kapacitetit të instaluar nga 1.25 MW në 3.89 MW dhe HC “Restelica I” dhe II, të cilat janë bashkuar në një objekt të hidrocentralit me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtat mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin ujit, Lejet ndërtimore dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Me datë 24.10.2013 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me vendimin V_572_2013 ka vendosur që ndërmarrjes “Eurokos JH” sh.p.k., t’i lëshohet Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC “Brodi II” (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC “Restelica I” dhe HC “Restelica II” (Krushevë) bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit.
- ZRRE ka konstatuar se zgjidhja teknike nr. 4517 e datës 09.09.2011 mbulon vetëm kapacitetet e përcaktuara me këtë Autorizim. Në rast se aplikuesi bënë kërkesë për HC “Brod I”, HC “Brod III” dhe HC “Restelica III”, atëherë duhet të silllet Zgjidhja teknike për këto njësi.
- Ndërsa për njësinë HC “Brod I” 1062 kW, HC “Brod III”(Kukalane) 3120 kW dhe HC “Restelica III” (Globoqicë) 1498 kW, të cilat janë pjesë e aplikacionit, ZRRE do ti shqyrtojë dhe do të vendosë pas sjelljes së Lejes Ujore për HC “Restelica III”, Zgjidhjes teknike për kyçje në rrjetin e shpërndarjes, Lejeve të Ndërtimit, dhe përmbushjes së kërkesave tjera sipas legjislacionit në fuqi.
- Me datë 21.01.2014 ZRRE nga ndërmarrja “Eurokos JH” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012 të datës 10 shkurt 2012, për njësinë gjeneruese HC “Brod I” 1062 kW, HC “Brod III” (Kukalane) 3120 kW dhe HC “Restelica III” (Globoqicë) 1498 kW, në Komunën e Dragashit, edhe për një afat shtesë.
- Me datë 12 mars 2014 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me vendimin V-605/1-2014, ka vendosur që të shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012 të datës 10 shkurt 2012, edhe për një afat gjashtë (6) mujor,




gjegjësisht deri me 10 gusht 2014, si dhe ka njoftuar se brenda këtij afati duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim, duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi. Pas Kalimit të këtij afati të fundit, Vendimi V_395_2012 i datës 10 shkurt 2012 mbi Njoftimi për Autorizimin Preliminar, për njësinë gjeneruese të mbetura do të shfuqizohet.


- ZRRE me datë 06.08.2014 ka pranuar kërkesën për herë të dytë të shoqërisë “Eurokos JH” sh.p.k., për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga UJi, për njësitë: HC “Brod I” 1062 kW, HC “Brod III” (Kukalane) 3120 kW dhe HC “Restelica III” (Globoqicë) 1498 kW, në Komunën e Dragashit, edhe për një afatë shtesë një (1) vjeçar.
- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, dhe duke u bazuar në Rregullin për Procedurën e Autorizimit, nenin 16 paragrafët 3 dhe 4 të cilat aplikohen edhe në rastin e Njoftimit për Autorizimin Preliminar, **ka vlerësuar se kërkesa është e pa bazuar dhe se kanë skaduar të gjitha afatet e mundshme të përcaktuara me Rregullën në fjalë**, andaj duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


- II. Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012 i datës 10 shkurt 2012, shfuqizohet.
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar